

32001L0013

Direktiva 2001/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001 që ndryshon Direktivën e Këshillit 95/18/KE për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore

Gazeta Zyrtare L 075, 15.03.2001 Fq. 0026-0028

Direktiva 2001/13/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2001, që ndryshon Direktivën e Këshillit 95/18 (KE) për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 71 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2)

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit të Rajoneve (3),

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit (4), duke pasur parasysh tekstin e përbashkët të miratuar më 22 nëntor 2000 nga Komiteti i Pajtimit,

Duke pasur parasysh që:

- (1) Direktiva e Këshillit 91/440/KEE e 29 korrikut 1991 për zhvillimin e hekurudhave të Komunitetit (5) parashikon disa të drejta përdorimi të transportit ndërkombëtar hekurudhor për ndërmarrjet hekurudhore dhe grupimet ndërkombëtare, ose ndërmarrjet hekurudhore.
- (2) Me qëllim sigurimin e shërbimeve të besueshme dhe të mjaftueshme, nevojitet një skemë e përbashkët licencimi për të siguruar, që të gjitha ndërmarrjet hekurudhore të plotësojnë në çdo kohë disa kërkesa në lidhje me emrin e mirë, besueshmërinë financiare, aftësinë profesionale, me qëllim mbrojtjen e klientëve dhe palëve të treta, dhe ofrimin e shërbimeve që përmbushin një standard të lartë sigurie;
- (3) Me qëllim që të drejtat e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore të zbatohen në të gjithë Komunitetin, në mënyrë të njëjtë dhe jodiskriminuese, Direktiva e Këshillit 95/18/KE (6) u kërkon ndërmarrjeve hekurudhore që ofrojnë shërbimet e përmendura në nenin 10 të Direktivës 91/440/KEE pajisjen me licencë, e cila është e detyrueshme për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe e vlefshme në të gjithë Komunitetin.
- (4) Meqë disa Shtete Anëtare kanë njohur të drejta përdorimi që tejkalojnë dispozitat e Direktivës 91/440/KEE, lind nevoja e sigurimit të një trajtimi të drejtë, transparent dhe jodiskriminues të të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore që ushtrojnë aktivitetin në këtë treg,

duke shprehur parimet e licencimit të përcaktuara nga Direktiva 95/18 (KE), për të gjitha kompanitë që veprojnë në sektor.

- (5) Me qëllim përmbushjen më mirë të detyrimit për informim, Shtetet Anëtare dhe Komisioni duhet të sigurojnë informacion më të mirë për të gjitha Shtetet Anëtare dhe Komisionin. Sipas praktikës së përbashkët dhe interpretimit logjik të Direktivës 95/18/KE, Shtetet Anëtare dhe Komisioni duhet të japin informacion edhe për licencat e dhëna.
- (6) Është e përshtatshme të garantohet që ndërmarrjet e licencuara hekurudhore, të cilat kryejnë transport ndërkombëtar mallrash, të respektojnë dispozitat përkatëse tatimore dhe doganore të zbatueshme, veçanërisht në lidhje me tranzitin doganor.
- (7) Në pajtim me parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 5 të Traktatit, objektivat e kësaj direktive, përkatësisht përcaktimi i parimeve të përgjithshme për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe njohja e ndërsjellë e këtyre licencave në të gjithë Komunitetin, nuk mund të arrihen në nivel të kënaqshëm nga Shtetet Anëtare, për shkak të dimensionit të dukshëm ndërkombëtar të dhënies të këtyre licencave, dhe për arsye të natyrës së tyre ndërshtetërore, mund të arrihen më mirë nga Komuniteti. Kjo direktivë nuk tejkalon atë që nevojitet për arritjen e këtyre objektivave.

(8) Për rrjedhojë, Direktiva 95/18/KE duhet të ndryshojë

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Direktiva 95/18/KE ndryshohet si vijon:

1) Neni 1 zëvendësohet si më poshtë:

“Neni 1

1. Kjo direktivë ka lidhje me kriteret e zbatueshme për dhënien, rinovimin ose ndryshimin e licencave nga një Shtet Anëtar për ndërmarrjet hekurudhore që janë krijuar ose do të krijohen në Komunitet.
2. Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive:
 - a) Ndërmarrjet që kryejnë vetëm shërbime hekurudhore të pasagjerëve në infrastrukturën e pavarur hekurudhore lokale dhe rajonale;
 - b) Ndërmarrjet hekurudhore që kryejnë vetëm shërbime hekurudhore urbane ose lokale për pasagjerë;

- c) Ndërmarrjet hekurudhore, aktiviteti i të cilave kufizohet në ofrimin e shërbimeve rajonale të ngarkesave të mallrave me rrugë hekurudhore, që nuk mbulohen nga fusha e zbatimit të Direktivës 91/440/KEE;
 - d) Ndërmarrjet që kryejnë vetëm aktivitete të transportit të mallrave në infrastrukturën hekurudhore private që ekziston vetëm për përdorim nga pronari i infrastrukturës për aktivitetet e tij të transportit të mallrave.
3. Ndërmarrjet, aktiviteti i të cilave kufizohet në ofrimin e shërbimeve të linjave vajtje-ardhje për automjete rrugore përmes Tunelit të Kanalit, përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive.”

2) Neni 2 pika (a) zëvendësohet si më poshtë:

“a) “ndërmarrje hekurudhore” nënkupton çdo ndërmarrje publike ose private, aktiviteti kryesor i të cilës është të ofrojë shërbime transporti hekurudhor për mallrat dhe/ose pasagjerët, me kushtin që ndërmarrja të sigurojë mjet hekurudhor tërheqës; kjo përfshin gjithashtu ndërmarrjet që sigurojnë vetëm mjet hekurudhor tërheqës”;

3) Neni 3 zëvendësohet si më poshtë:

“Neni 3

Çdo Shtet Anëtar cakton organin përgjegjës për dhënien e licencave dhe përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga kjo direktivë. Licencat jepen nga një organ që nuk ofron vetë shërbime transporti hekurudhor, dhe është i pavarur nga organet ose ndërmarrjet që ofrojnë shërbime transporti hekurudhor.”

4) Në nenin 4 shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“5. Licenca është e vlefshme në të gjithë territorin e Komunitetit.”

5) Paragrafi i katërt i nenit 6, zëvendësohet si më poshtë:

“është/nuk është dënuar për mospërmbushje të rënda ose të përsëritura të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni social ose i punës, përfshirë edhe detyrimet sipas legjislacionit shëndetësor dhe të sigurisë në vendin e punës, dhe detyrimet sipas legjislacionit doganor, në rast të një kompanie që kërkon të kryejë transport mallrash ndërkufitare në përputhje me procedurat doganore”;

6) Neni 11 pika (8) zëvendësohet si më poshtë:

“8. Kur autoriteti licencues jep, pezullon, shfuqizon ose ndryshon një licencë, Shteti Anëtar përkatës informon menjëherë Komisionin në mënyrën e duhur. Komisioni informon menjëherë Shtetet e tjera Anëtare”.

7) Nenet 12 dhe 13 zëvendësohen si më poshtë:

“Neni 12

1. Përveç kërkesave të kësaj direktive, ndërmarrja hekurudhore respekton edhe dispozitat e së drejtës kombëtare miratuar në përputhje me të drejtën Komunitare, dhe zbaton në mënyrë jodiskriminuese, në veçanti:
 - a) Kërkesat specifike teknike dhe të ushtrimit të aktivitetit për shërbimet hekurudhore;
 - b) Kërkesat e sigurisë që zbatohen për personelin, mjetet hekurudhore dhe organizimin e brendshëm të ndërmarrjes;
 - c) Dispozitat mbi shëndetin, sigurinë, kushtet sociale dhe të drejtat e punëtorëve dhe konsumatorëve;
 - d) Kërkesat që zbatohen për të gjitha ndërmarrjet në sektorin përkatës hekurudhor, që synojnë të ofrojnë përfitime për ose mbrojtje të konsumatorëve.
2. Ndërmarrja hekurudhore mund t'i referojë në çdo kohë Komisionit çështjen e përputhshmërisë së kërkesave të legjislacionit kombëtar me atë Komunitar, dhe gjithashtu çështjen, nëse këto kërkesa zbatohen në mënyrë jodiskriminuese. Nëse Komisioni çmon se dispozitat e kësaj direktive nuk janë respektuar, jep mendim në lidhje me interpretimin e saktë të direktivës pa cenuar nenin 226 të Traktatit.

“Neni 13

Ndërmarrja hekurudhore respekton marrëveshjet në fuqi për transportin hekurudhor ndërkombëtar në Shtetet Anëtare në të cilat kryen aktivitetin. Ato respektojnë gjithashtu dispozitat përkatëse tatimore dhe doganore.”

Neni 2

Shtetet Anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative, të nevojshme në zbatim të direktivës, deri në datën 15 mars 2003. Ata informojnë menjëherë Komisionin në lidhje me këtë.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto dispozita, ato i referohen kësaj direktive ose i shoqërojnë këto dispozita me një referencë të botimit të direktivës në Gazetën Zyrtare. Metodot për të bërë një referencë të tillë përcaktohen nga vetë Shtetet Anëtare.

Neni 3

Kjo direktivë hyn në fuqi ditën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 4

Kjo direktivë i drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 26 shkurt 2001

Për Parlamentin European

Presidenti

N. Fontaine

Për Këshillin

Presidenti

A. Lindh

(1) GZ C 321, 20.10.1998, fq. 8, dhe

GZ C 116E, 26. 4.2000, fq. 38

(2) GZ C 209, 22. 7. 1999, fq. 22

(3) GZ C 57, 29.2.2000, fq. 40.

(4) Mendim i Parlamentit European i 10 marsit 1999 (GZ C 175, 21. 6.1999, fq. 119), konfirmuar më 16 shtator 1999 (GZ C 54, 25.2.2000, fq. 56, Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i 28 marsit 2000 (GZ C 178, 27. 6. 2000, fq. 23) dhe Vendimi i Parlamentit European i 5 korrikut 2000 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Parlamentit European i 1 shkurtit 2001 dhe Vendimi i Këshillit i 20 dhjetorit 2000.

(5) GZ L 237, 24. 8. 1991, fq. 25. Direktiva e ndryshuar nga Direktiva 2001/12/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit (shih faqen 1 të kësaj Gazete Zyrtare).

(6) GZ L 143, 27.6.1995, fq. 70.